

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2017

Zhvillime të tjera

- AMF organizon trajnimin e asistencës teknike dhe këmbimit të informacionit (TAIEX) të Komisionit Evropian
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvillon vizitë në institucionet homologe polake në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimit të eksperiencës
- Vizitë studimore “Licencimi dhe mbikëqyrja e ndërmjetësve në sigurime”

Edukimi i Konsumatorit

- “Eksplorimi i Horizonteve të Reja” (Pjesa e fundit)

Lajme Ndërkombëtare

- Azerbaxhan
- Greqi
- Lituani
- Rumani

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2017

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-shkurt 2017 kapën vlerën mbi 2.37 miliardë lekë, ose 25.10% më shumë se gjatë periudhës janar-shkurt 2016. Gjatë periudhës janar-shkurt 2017, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 189,943 me një rritje prej 33.45% krahasuar me janar-shkurt 2016.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 70.71% në krahasim me periudhën janar-shkurt 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.36 miliardë lekë, apo 4.19% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 25.65% gjatë periudhës janar-shkurt 2017, krahasuar kjo me periudhën janar-shkurt 2016.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 1.42 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shkurt 2017, duke shënuar një rritje prej 21.95% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 60.13% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 12.32% të tregut të Jo-Jetës;
- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 8.49 % të tregut të Jo-Jetës.


Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 18.34% krahasuar me periudhën janar-shkurt 2016. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit "Jetë debitor", e cila përbën 60.40% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 1.42 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shkurt 2017.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-shkurt 2017

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

AMF organizon trajnimin e asistencës teknike dhe këmbimit të informacionit (TAIEX) të Komisionit Evropian

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadër të aplikimit në instrumentin e asistencës teknike dhe këmbimit të informacionit (TAIEX) të Komisionit Evropian organizoi në datat 15–16 mars 2017 trajnimin në formën e misionit të ekspertëve (*Expert Mission*) për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit. Ky aktivitet u organizua si bashkëpunim i Komisionit Evropian me IVASS (Autoriteti Italian i Sigurimeve).



Gjatë zhvillimit të trajnimit të asistencës teknike dhe këmbimit të informacionit (TAIEX) të Komisionit Evropian në ambientet e AMF-së

○ ○ ○
Trajnim në formën e misionit të ekspertëve (*Expert Mission*) për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit.
○ ○ ○

Qëllimi i këtij trajnimi ishte shkëmbimi i njohurive dhe informacionit në fushën e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit duke u fokusuar në:

- Funksionimin e sistemit *Bonus-Malus*;
- Funksionimin e Fondit të Garancisë;
- Masat antimashtrim;
- Shlyerjen dhe trajtimin e dëmshpërblimeve.

Misioni mundësoi edhe diskutimin e disa çështjeve dhe problematikave të hasura nga ekspertët dhe pjesëmarrësit në punën e tyre të përditshme mbikëqyrëse dhe rregullatore, si dhe në lidhje me zbatimin e rregullave të ndryshme për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

Ekspertët e IVASS që morën pjesë në këtë aktivitet ishin Z. Antonio De Pascalis, Drejtor i Departamentit të Kërkimit dhe i Menaxhimit të të Dhënave, Z. Massimo Amato, Specialist në Sektorin e Anti-mashtrimit dhe Z. Lino Matarazzo, aktuar në Sektorin e Studimeve dhe Analizave Statistike, me një eksperiencë shumë të gjatë në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvillon vizitë në institucionet homologe polake në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimit të eksperiencës

Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi dhe përfitimi nga eksperiencia polake dhe ajo ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimi i mëtejshëm në funksion të përmirësimit të infrastrukturës TIK dhe programeve aktuale të Qendrës së Informacionit.

Me kërkesë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, informimit dhe shkëmbimit të eksperiencës, në datat 9 dhe 10 mars 2017 u zhvillua një vizitë pune me institucionet homologe polake, Komisionin e Mbikëqyrjes Financiare (KNF) dhe Fondin e Garancisë së Sigurimeve (UFG).

Në takimet e zhvilluara pranë institucioneve homologe polake çështjet dhe temat kryesore që u trajtuan dhe prezantuan nga ekspertët polakë ishin në fushat kryesore me interes për AMF-në që lidheshin me:

1. Zgjidhjet e Teknologjisë së Informacionit, platformat dhe aplikimet (teknike dhe funksionale) në funksion të përmbushjes së detyrave kryesore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:

- Menaxhimi i riskut dhe kontrollet e brendshme;
- Analiza dhe raportimi nga platformat (monitorimi *off-site* dhe inspektimi *on-site*).

2. Sfidat dhe nevojat e identifikuara për përmirësim.

Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi dhe përfitimi nga eksperiencia polake dhe ajo ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimi i mëtejshëm në funksion të përmirësimit të infrastrukturës TIK dhe programeve aktuale të Qendrës së Informacionit sipas eksperiencave dhe zgjidhjeve më të suksesshme të entiteteve të ngjashme me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Vizitë studimore “Licencimi dhe mbikëqyrja e ndërmjetësve në sigurime”

Në datat 28-29 mars 2017 në Budapest, Hungari, u zhvillua një vizitë studimore me temë “Licencimi dhe mbikëqyrja e ndërmjetësve në sigurime”.

Qëllimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Autoritetit në këtë vizitë studimore ishte forcimi i kapaciteteve të punonjësve të AMF-së, njohja me legjislacionin dhe praktikën më të mira evropiane në kuadër të aplikimit në instrumentin e asistencës teknike dhe këmbimit të informacionit (TAIEX) të Komisionit Evropian në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Hungarisë (*Magyar Nemzeti Bank*).

Aktiviteti u organizua mbi bazën e prezantimeve të përgatitura me profesionalizëm nga organizatorët dhe diskutimeve nga pjesëmarrësit pas çdo tematike.

Çështja kryesore ku u fokusua aktiviteti ishte mbikëqyrja e ndërmjetësve në sigurime, kryesisht e subjekteve që kryejnë veprimtari brokerimi.

Çështja kryesore ku u fokusua aktiviteti ishte mbikëqyrja e ndërmjetësve në sigurime, kryesisht e subjekteve që kryejnë veprimtari brokerimi. Për të zhvilluar rolin dhe procedurën e mbikëqyrjes u trajtuan temat e mëposhtme, si:

- Mjetet rregullative për mbikëqyrjen e ndërmjetësve në sigurime;
- Procesi mbikëqyrës bazuar në mbikëqyrjen me bazë rrisht nga evidentimi i problemit deri tek investigimi, inspektimi dhe raporti përfundimtar;
- Evidentimi i rrisqeve kryesore me të cilat përballet tregu, ndërmjetësi dhe konsumatori nga veprimet apo mosveprimet e ndërmjetësve;
- Raportet dhe treguesit kryesorë të ndërtuar mbi bazën e të dhënave të raportuara nga ndërmjetësit, si dhe;
- Publikimet e rregullatorit për informimin e publikut mbi aktivitetet financiare të ndërmjetësve.

Pjesë të diskutimit ishin edhe kërkesat rregullatore mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e ndërmjetësve të përcaktuara në direktivën e ndërmjetësimit dhe veçanërisht ndryshimet që sjell zbatimi i direktivës së re të ndërmjetësimit, e cila hyn në fuqi në vitin 2018.

Eksplorimi i Horizonteve të Reja

Fjala e Z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA) mbajtur në Konferencën e 6-të Vjetore në Frankfurt, 18 tetor 2016. Duke reflektuar vizionin dhe strategjinë e re të EIOPA-s, tematika e konferencës u fokusua në “Eksplorimin e horizonteve të reja” nëpërmjet tre paneleve. Tematikat kryesore të fjalës së mbajtur nga Z. Bernardino lidheshin me katër çështje: (i) metoda gjithëpërfshirëse e EIOPA-s për konvergjencën në mbikëqyrje (supervisory convergence); (ii) zhvillimi i produkteve personale të pensionit në Evropë (Pan-European Personal Pension Product, PEPP) në kuadrin e Bashkimit të Tregjeve të Kapitalit; (iii) prioritetet e axhendës së EIOPA-s për mbrojtjen e konsumatorit e lidhur me zbatimin e direktivës Insurance Distribution Directive (IDD) në procesin e dixhitalizimit; (iv) hapat e mëtejshëm në kuadrin rregullator dhe sfidat në vazhdim

(Pjesa e fundit)

<https://eiopa.europa.eu/Publications/Speeches%20and%20presentations/2016-10-18%20EIOPA%20Annual%20Conference.pdf>

Tema ime e katërt lidhet me hapat dhe sfidat e sistemit rregullator në të ardhmen.

Siguria dhe qëndrueshmëria e sistemit rregullator është një vlerë e rëndësishme që ne të gjithë duhet të ruajmë. Rishikimi i *Solvency II* duhet të ndjekë procesin e parashikuar në tekstet legjislativ: deri në vitin 2018, duhen shqyrtuar Kërkesat Minimale për Kapital (*Solvency Capital Requirement, SCR*) dhe deri në 2021, rishikimi i përgjithshëm, duke përfshirë edhe trajtimin e garancive afatgjata.

Pas kërkesës së bërë nga Komisioni Evropian për këshillime, EIOPA do të publikojë para fundit të këtij viti një dokument diskutimi lidhur me shqyrtimin e Kërkesave Minimale për Kapital (SCR). Gjatë vitit 2017 do të organizohet një seri tryezash të rrumbullakëta me të gjitha palët e interesuara lidhur me këtë çështje. EIOPA është e angazhuar për hartimin e politikave të bazuara në evidenca.

Solvency II është padyshim një arritje e madhe për sektorin e sigurimeve në vendet e Bashkimit Evropian ashtu si edhe për mbrojtjen e konsumatorit në sigurime. Megjithatë ka ende disa fusha ku nevojitet progres për të përfunduar kuadrin gjithëpërfshirës rregullator të Bashkimit Evropian. Unë jam duke folur për kuadrin *makro-prudencial*, mekanizmat e zgjidhjes dhe të rikuperimit, si edhe skemat e garantimit të sigurimit. Në këtë kontekst duhen analizuar edhe standardet ndërkombëtare.

Kuadri makro-prudencial

Sektori i sigurimeve luan një rol të rëndësishëm në arritjen e një sistemi financiar të qëndrueshëm, duke mbështetur rritjen ekonomike të qëndrueshme

Solvency II është padyshim një arritje e madhe për sektorin e sigurimeve në vendet e Bashkimit Evropian ashtu si edhe për mbrojtjen e konsumatorit në sigurime.

e afatgjatë. Kështu, zbutja e mundësisë së ndodhjes dhe ndikimit të një krize sistematike në tregun e sigurimeve duhet të jetë një objektivi i rëndësishëm i politikës.

Duhet të punohet në drejtim të krijimit të një kuadri të plotë *makro-prudencial* të Bashkimit Evropian për tregun e sigurimeve, i cili konsideron natyrën specifike të biznesit të sigurimit dhe modelet e financimit. Duhet pasur parasysh se edhe pse *Solvency II* është një regjim mikrobikëqyrës, ai përmban elementë *makro-prudenciale*. Një vlerësim i plotë i efektivitetit makro të këtyre elementëve duhet të bëhet në vitet e ardhshme.

Hyrja në fuqi e *Solvency II* dhe sidomos miratimi i kërkesave për kapital do të ulin gjasat e dështimeve në tregun e sigurimeve. Megjithatë është e rëndësishme të kuptohet se *Solvency II* nuk është një regjim me zero-dështim dhe mund të ndodhin edhe dështime.

Mekanizmat e zgjidhjes dhe rimëkëmbjes

Një nga mësimet e nxjerra nga kriza e fundit financiare është nevoja për të pasur mjetet e përshtatshme të zgjidhjes të cilat do t'i mundësojnë autoritetet kombëtare të ndërhyjnë në rastet e dështimit të institucioneve apo për të zgjidhur problematikat e ndryshme.

Aktualisht, në tregun e sigurimeve të Bashkimit Evropian nuk ka qasje të harmonizuara për të gjithë vendet përse i përket zgjidhjes dhe rikuperimit në rastet e problematikave. Aktualisht ka dallime të konsiderueshme midis vendeve dhe shpesh nuk ndiqen elementet përkatëse të cilat Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB), i konsideron të nevojshme për një regjim efektiv. Në kushtet e mungesës së një regjimi të përbashkët për vendet e Bashkimit Evropian, shfaqja e zgjidhjeve të veçanta kombëtare do të rrisë fragmentimin e tregut të brendshëm e do të krijojë vështirësi shtesë në trajtimin e çështjeve ndërkufitare.

EIOPA ka filluar punën në këtë drejtim dhe do të publikojë një dokument diskutimi para fundit të vitit, duke pasqyruar kushtet aktuale dhe shpalosjen e ideve të para për harmonizimin e të paktën disa prej praktikave rimëkëmbëse për siguruesit në vendet e Bashkimit Evropian.

Skemat e garantimit të sigurimeve

Hyrja në fuqi e *Solvency II* dhe sidomos miratimi i kërkesave për kapital do të ulin gjasat e dështimeve në tregun e sigurimeve. Megjithatë është e rëndësishme të kuptohet se *Solvency II* nuk është një regjim me zero-dështim dhe mund të ndodhin edhe dështime. Rol këtu duhet të luajnë edhe skemat e garantimit të sigurimeve, të cilat kontribuojnë për të rritur mbrojtjen e përgjithshme të të siguruarve. Megjithatë, në vendet e Bashkimit Evropian, kjo çështje është ende e fragmentarizuar, ku skemat ekzistuese kanë ndryshime të ndjeshme për sa i përket financimit, funksioneve, mandatit dhe mbulimit. Ky fragmentim krijon probleme të veçanta sidomos në biznesin ndërkufitar të sigurimeve.

Unë besoj, se në periudhë afatmesme është themelore, si për mbrojtjen e konsumatorit dhe për funksionimin e duhur të tregut të brendshëm, të ndërtohet një qasje e harmonizuar për skemat e garancisë së sigurimeve në Bashkimin Evropian.

Standardet ndërkombëtare

Rishikimi i *Solvency II* që do të kryhet në vitin 2021 mund të përfitojë nga progresi i arritur në nivel ndërkombëtar, në veçanti lidhur me rrezikun sistemik dhe standardet ndërkombëtare të kapitalit (ICS).

Sfida për vitet e ardhshme është zhvillimi i asaj që quhet "gjenerata e tretë e politikave ndaj rrezikut sistemik në sektorin e sigurimeve". Hartimi i politikave duhet të marrë parasysh faktorët e zbutjes dhe kërkesat e kapitalit, të përfshira në regjimin *mikro-prudencial* për të shmangur difektet apo dublikimet.

Natyra globale e tregut të sigurimeve kërkon një regjim të aftësisë paguese të grupeve, globalisht të shëndetshëm e të fuqishëm i cili duhet të zbatohet nga të gjitha juridiksionet.

Për të përfunduar, Presidenti Juncker ka thënë së fundmi se "Bashkimi ynë Evropian është, të paktën pjesërisht, në një krizë ekzistenciale". Qytetarët evropianë kërkojnë përgjigje konkrete për sfidat e kohës sonë dhe hartuesit e politikave të Bashkimit Evropian duhet t'ua ofrojnë këtë.

- Prandaj, ne të gjithë duhet të përmirësojmë punën tonë në përputhje me rrethanat dhe pa vonesë në fushat tona përkatëse të përgjegjësisë;
- Mbikëqyrësit duhet të punojnë së bashku për të siguruar që të gjithë zotëruesit e policave të sigurimit të jenë të mbrojtur me mbikëqyrje të cilësisë së lartë;
- Produktet e tregut të sigurimeve dhe produktet e pensioneve private duhet të sigurohet që kanë mbrojtjen e duhur dhe rikthim të mirë të investimeve për qytetarët;
- Konsumatorët dhe kompanitë duhet të përfitojnë nga potenciali i plotë i një tregu unik;
- Inovacionet e sjella nga revolucioni dixhital duhet të japin rezultate më të mira për qytetarët.

Më shumë se fjalët, tani është koha për veprim! Është koha për të gjithë ne për të "eksploruar horizonte të reja" për të ofruar një Evropë më të mirë për qytetarët tanë evropianë.

—○○○—
Natyra globale e tregut të sigurimeve kërkon një regjim të aftësisë paguese të grupeve, globalisht të shëndetshëm e të fuqishëm i cili duhet të zbatohet nga të gjitha juridiksionet.
—○○○—

Azerbaxhan

www.xprimm.com

Në fund të vitit 2016, 25 kompanitë e sigurimeve të Azerbaxhanit raportuan një vlerë të primeve të shkruara bruto prej rreth 260 milionë euro, me një rritje prej rreth 9.7% më shumë se gjatë vitit 2015. Dëmet e paguara nga siguresit vendas arritën vlerën e rreth 127 milionë euro, ose 32% më shumë se vitin e kaluar.

Në volumin total të primeve të shkruara bruto rreth dy të tretat e tregut përbëhet nga sigurimet vullnetare dhe pjesa tjetër nga sigurimet e detyrueshme.

Përsa i takon volumit të primeve të shkruara bruto, pesë kompanitë më të mira të sigurimeve gjeneruan rreth 61% të volumit total të primeve.

Greqi

www.xprimm.com

Sipas publikimeve nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimit (HAIC), në vitin 2016 tregu grek i sigurimeve shënoi një rritje prej 4.6%, krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur vlerën e primeve të shkruara bruto prej 3.78 miliardë euro. Ky rezultat ka të përfshirë aktivitetin e 56 anëtarëve të Shoqatës Greke të Kompanive të Sigurimit, e cila përfaqëson rreth 97.1% të të ardhurave nga primet në total.

Nga krahasimi i të dhënave të këtyre kompanive për vitin 2016 me ato të vitit 2015, shihet se:

- Primet e sigurimit të Jetës arritën vlerën 1.91 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 6.1%;
- Primet e sigurimit të Jo-Jetës arritën vlerën 1.87 miliardë euro, duke u rritur me 3.1% krahasuar me vitin e kaluar.

Presidenti i shoqatës HAIC, Z. D. Mazarakis komentoi rreth studimit: "Prodhimi i tregut grek të sigurimeve për vitin 2016, tregon të dhëna pozitive për vitin e kaluar dhe krijon optimizëm për vitin 2017. Në të njëjtën kohë, pasiguria dhe paqëndrueshmëria në mjedisin politik dhe ekonomik, kanë pasur ndikim direkt dhe indirekt tek të ardhurat dhe bizneset në dispozicion, ndërsa normat e ulëta të interesit mjedisor dhe nevojat në rritje të kuadrit rregullator nuk lënë vend për vetëkënaqje, por për vigjilencë dhe përshtatje në vazhdimësi me kushtet dhe sfidat e reja. Pavarësisht mjedisit ekonomik të disfavorshëm gjatë viteve të fundit, tregu i sigurimeve ka qenë në gjendje të përshtatet gjerësisht dhe kjo prirje do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2017, duke zhvilluar dhe duke krijuar kushtet e përshtatshme për të gjitha palët, si për të siguruarit, siguresit, punonjësit, aksionarët dhe shoqërinë greke".

Lituani

www.xprimm.com

Siguruesit në Lituani raportuan një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 709.8 milionë euro gjatë vitit 2016, duke shënuar një rritje të tregut të sigurimeve prej 10%. Volumi i primeve të sigurimit për veprimtarinë e Jo-Jetës ishte 463.1 milionë euro gjatë vitit 2016, duke shënuar një rritje prej 13.2% krahasuar me vitin e kaluar, e ndikuar kryesisht e nga klasat e sigurimit motorik.

Tregu i sigurimeve të Jetës u rrit me 4.6% krahasuar me vitin e kaluar duke shënuar vlerën 246.7 milionë euro. Një kontribut pozitiv në rezultatin e sektorit të sigurimit të Jetës erdhi nga një rritje e lartë rekord në shumën e të vetmeve primeve të sigurimit brenda njësisë dhe indeksit të lidhur me klasën e sigurimeve, duke llogaritur peshën më të madhe në tregun e sigurimit të Jetës.

Në njoftimin e Bankës Qendrore të Lituaniës theksohet se ecuria e tregut "... ishte pothuajse në linjë me parashikimin e mëparshëm të Bankës së Lituaniës, që tregu i sigurimeve të Jo-Jetës do të përshpejtonte normën e tij të rritjes, ndërsa tregu i sigurimit të Jo-Jetës kishte arritur rezultate edhe më të mira". Banka e Lituaniës parashikon se tregu vendas i sigurimeve do të ketë rritje më të vogël gjatë vitit 2017, me rreth 6-7% në sigurimet e Jo-Jetës, ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës është drejt rënies".

Rumani

www.xprimm.com

Sipas njoftimit për shtyp të publikuar nga autoriteti mbikëqyrës i Rumanisë, (FSA) gjatë vitit 2016, tregu rumun i sigurimeve ka vazhduar tendencën rritëse duke arritur një volum total të primeve të shkruara bruto rreth 2.1 miliardë euro, e cila shënon një rritje prej 10% më shumë krahasuar me vitin e kaluar.

Sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti Mbikëqyrës i Rumanisë, në volumin total të primeve të shkruara bruto, pjesën më të madhe të primeve e zënë ato të klasave MTPL, sigurimi Kasko dhe sigurimi nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera natyrore. Këto klasa zunë së bashku rreth 89% të totalit të përgjithshëm primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës.

Tregu i sigurimeve karakterizohet nga një shkallë e lartë e përqendrimit. Gjatë vitit 2016, rreth 87% e vëllimit total të primeve të shkruara bruto, u realizua nga 10 kompani të sigurimeve. Një vit më parë kjo shifër ishte realizuar nga 31 kompani sigurimesh.

amf ALBANIA

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al